

Dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuar

Dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuar (PAK), 3 Dhjetor, synon ndërgjegjësimin e shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të përfituesve për t'u bërë pjesë dhe për t'u përfshirë në procesin e integritetit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore.

Por si mund ta përkufizojmë aftësinë e kufizuar

Deri në fund të viteve 80 aftësia e kufizuar ose përkufizimi i aftësisë së kufizuar kanë qenë një çështje e debatit në Evropë dhe në botë. Në diskutimet botërore njohuritë, hipotezat dhe perceptiviteti për aftësinë e kufizuar janë grupuar në disa modele, si:


- **Modeli i Bamirësisë/Keqardhjes /Mëshirës, vitet 60-70**, sipas të cilit personat me aftësi të kufizuar janë për tu mëshiruar për të ardhur keq dhe kanë nevojë për ndihmën tonë, simpatinë, dhëmbshurinë, asistencë në mënyrë që të ecin para.
- **Modeli Mjekësor, vitet 70 -80**, sipas të cilit personat me aftësi të kufizuar janë pacientë me probleme fizike të individit ,që duhen mjekuar, trajtuar apo ndërhyrë ,për të zgjidhur problemin individual, duhet të ndryshojnë këta dhe jo shoqëria dhe janë persona që kërkojnë shërbime speciale.
- **Modeli Social, fundi i viteve 80 fillimi 90**, sipas të cilit personat me aftësi të kufizuar konsiderohen të jetë të tillë si rezultat i barrierave sociale që i ndalon ata të marrin pjesë në shoqëri ,pra është një problem i krijuar nga shoqëria duke mos ja atribuar atë individit
- **Modeli i bazuar në të drejtat, fundi i viteve 90**, sipas të cilit personat me aftësi të kufizuar që shpesh u janë refuzuar të drejtat bazë njerëzore si psh e drejta për shëndet ,edukim, punësim. Personat me aftësi të kufizuar janë të ndryshëm por shoqëria duhet ti mbështesë dhe ti respektojë pse ata janë të ndryshëm. Personat me aftësi të kufizuar janë qytetarë të barabartë dhe prandaj duhet të gëzojnë të drejta dhe përgjegjësi të njëjta.
- **Modeli i aftësisë mbas vitit 2000**, sipas të cilit personave me aftësi të kufizuar duhet tu jepet mundësia të ushtrojnë kapacitetin e tyre të vërtetë, të zhvillojnë potencialin e tyre, të zgjedhin jetën e tyre. Sipas këtij modeli të rëndësishme janë potencialiteti, kapaciteti i personit dhe jo kufizimet e tyre.

Një revolucion të vërtetë në përkufizimin, e në perceptimin e shëndetit dhe aftësisë së kufizuar e bëri OBSH në vitin 2001 ,me lançimin e “Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit” (ICF).

Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF) e përcakton aftësinë e kufizuar si një term ombrellë **për dëmtime, kufizimet e aktivitetit dhe kufizimet e pjesëmarrjes. Dëmtimi**; është një problem i funksionimit të trupit apo strukturës së tij, (funksionet fiziologjike apo psikologjike apo pjesët anatomike të trupit).

Kufizimi i aktivitetit, është një vështirësi që haset nga një individ në kryerjen e një detyre apo veprimi.

Kufizimet e pjesëmarrjes, nënkupton vështirësitë që një individ mund të ndeshë gjatë përfshirjes në situata të jetës së përditshme.



Kështu aftësia e kufizuar është një fenomen kompleks, është ndërveprimi mes individëve me një gjendje shëndetësore (paralizë cerebrale p.sh., Doën sindrom dhe depresioni) dhe faktorëve personal dhe mjedisor (p.sh. qëndrimet negative, transporti i paarritshëm dhe ndërtesat publike, dhe mbështet të kufizuara sociale).

Aftësia e kufizuar është jashtëzakonisht e larmishme. Aftësia e kufizuar nuk është kështu vetëm një problem shëndetësor. Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat nevoja shëndetësore si edhe personat jo me aftësi të kufizuara, kanë nevojë për imunizim, depistim të kancerit, etj. Por ata gjithashtu janë më të prekshëm nga një sëmundje apo një problem shëndetësor, si për shkak të varfërisë, për shkak të përjashtimit social, gjithashtu edhe për shkak se ata mund të jenë më të prekshëm nga sëmundjet sekonadre, të tilla si plagë apo infeksionet e traktit urinar. Provat tregojnë se njerëzit me aftësi të kufizuara përballen me pengesa në aksesin për shërbime shëndetësore dhe rehabilituese për të cilat ata kanë nevojë për më shumë ambiente.

Fakte Sipas Bankës Botërore dhe OBSH

Persona me aftësi të kufizuar ka në çdo vend të botës dhe në të gjitha nivelet e çdo shoqërie. Numri i personave me aftësi të kufizuar në botë është i madh dhe në rritje.

Mbi një miliard njerëz, apo rreth 15% e popullsisë së botës, kanë një formë të aftësisë së kufizuar, nga të cilat mbi 200 milionë janë fëmijë.

110 milion deri 190 milion njerëz kanë vështirësi të konsiderueshme në funksionim.

Përqindja e personave me aftësi të kufizuar është rritur ndër shkaqet e tjera, për shkak të plakjes së popullsisë dhe rritjes së sëmundjeve kronike.

Njerëzit me aftësi të kufizuara kanë më pak akses në shërbimet shëndetësore dhe për këtë arsye ata përfutrojnë nevojat të e pajtësuarat të shërbimit të kujdesit shëndetësor.

Rreth 80% e e popullsisë së botës së njerëzve me aftësi të kufizuara jetojnë në vendet me të ardhura të pakta me disavantazhe ekonomike dhe mohim të të drejtave. 20 % e të varfë rve kanë disa forma disabiliteti.

Aftësia e kufizuar takohen më shumë tek personat me arsim të ulët 19 % , përkundrajt atyre me arsim tjetër 11%.

90% e personave me aftësi të kufizuar nuk shkojnë në shkollë.

Aftësia e kufizuar takohen më shumë tek gratë dhe këto bëhen shkak për abuzime

Vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç me Aftësia e kufizuar është mjaft e lartë.

Aftësitë e kufizuara më të zakonshme janë të lidhur me sëmundje kronike, si sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet kronike të rrugëve të frymëmarrjes, kancerit dhe diabetit; lëndime, të tilla si ato për shkak të trafikut rrugor, rrëzimet, minat tokësore dhe dhuna, sëmundjet mendore, kequshqyerja; HIV / AIDS dhe të sëmundjeve të tjera infektive.

Vendi ynë

Në vendin tonë personat me aftësi të kufizuar janë identifikuar me terma të ndryshëm si, invalidë, të paaftë, handicapë, para-tetraplegjike, persona me prapambetje mendore, të verbër , etj.

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara dhe konceptet e Mundësive të Barabarta të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh), termi “person me handicap” është zëvendësuar me termin “Person me Aftësi të Kufizuar” (individualisht) dhe “Persona me Aftësi të Kufizuara” (në nivel shoqëror).

Sipas **Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara 2005**, tani e në vazhdim “Personat me Aftësi të Kufizuar” janë ata persona të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore.

Person me aftësi të kufizuara (PAK) quhet individ, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko/mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

Duke ju referuar strategjisë, të dhënat dhe njohuritë statistikore për pozitën e personave me aftësi të kufizuara janë të pakta. Aktualisht ato reduktohen në numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet kryesore të aftësive të kufizuara, të cilat vlerësohen dhe përcaktohen nga komisione të veçanta specialistësh, pagesat në para që jepen nga buxheti i shtetit, si dhe disa

shërbime mbështetëse që ofrohen në qendra rezidenciale dhe në komunitet. Aktualisht nuk ka të dhëna mbi strukturën gjinore të personave me aftësi të kufizuara, për aftësitë e kufizuara pas moshës së pensionit, të dhëna lidhur me situatën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, Niveli i punësimit të personave me aftësi të kufizuar është tepër i ulët.

Sipas llojit të aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuar janë: personat me aftësi të kufizuar dëgjimore dhe pamore,(Sensorë); personat me aftësi të kufizuara lëvizëse si: para e tetraplegjiket, etj,(Fizikë); persona me çrregullime mendore ose sëmundje mendore kronike,(mendorë).

Vlerësimi i aftësisë së kufizuar në vendin tonë vlerësohet nga komisione të veçanta të specializuara, në përbërje të të cilëve ka specialistë të disiplinave të ndryshme, si: mjekë pediatër, okulistë, psikiatër etj.

Komisionet që vlerësojnë PAK janë: Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, (KMCAP), Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë (KMPV)

Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë i klasifikon personat me aftësi të kufizuara në:

Grupi 1 janë personat me aftësi të kufizuara të lindur ose që janë bërë të tillë deri në moshën 21 vjeç;

Grupi 2 përfshin personat e aksidentuar, të sëmurur me sëmundje profesionale dhe të përgjithshme të bërë gjatë punës, kur kanë qenë të siguruar.

Një grup tjetër janë Invalidët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare .

Numuri i personave me aftësi të kufizuara sa vjen e rritet,kështu në vitin 2003 kishim 75.044 persona,në vitin 2004 kishim 77.248 persona,në vitin 2008 numuri i tyre ka qënë 105.972 persona ; në vitin 2009 kemi 122.360 persona ,dhe në vitin 2010 kemi 133 mijë persona me aftësi të kufizuara ose 3.7 % e popullsisë së vendit.

Sondazhe të kryera tregojnë se edhe në vendin tonë personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre ende i përkasin pjesës së marginalizuar të shoqërisë shqiptare. Ata janë të varfër dhe të izoluar në një shoqëri të cilës ende i duhet të zhdukë barrierat arkitektonike dhe shoqërore. Shërbimet shëndetësore, arsimore, shoqërore dhe ato të punësimit për personat me aftësi të kufizuara janë të pakta dhe të një cilësie të dobët.

Jetojmë në një shoqëri e cila nuk është plotësisht e hapur ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar.

Agroni "Aktualisht unë jetoj në një apartament, në një pallat të ri që edhe pse ka ashensor, ai fillon në një lartësi mes kati, dhe ka shumë shkallë për të arritur tek ai. Kjo më ka detyruar të kërkoj një tjetër banesë për t'u strehuar, në një pallat që minimalisht të ketë ashensor që fillon që nga kati përdhe (më e mira nëse fillon nga parkimi nentokësor) dhe që ashensori të ketë përmasa që të mund të futet karrigia ime në të.Jam duke kërkuar në të gjithë Tiranën për një

pallat që të ketë këto kushte. Ajo që kam gjetur deri tani është një numër gjithnjë e në rritje personash të tjerë me aftësi të kufizuar në kushtet e mija, me të cilët apo edhe me familjarët e tyre, po takohemi gjithnjë e më shpesh para pallatesh që na ofrojnë çdo lloj pengese dhe vetëm zgjidhje jo.”



Ndaj, Dita botërore Personave me Aftësi të Kufizuar, 3 Dhjetor, synon të promovojë të kuptuarit e çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe për të mobilizuar mbështetje për të drejtat, dinjitetin dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuar. Ajo kërkon gjithashtu të rrisë ndërgjegjësimin e përfitimeve që do të rrjedhin nga përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në çdo aspekt të jetës.

Për më shumë informacion mbi aftësinë e kufizuar kërkonit në adresat e mëposhtme:

- www.idpwd.com.au
- www.who.int/disabilities
- www.un.org/disabilities

Për më shumë informacion mbi aftësinë e kufizuar në vendin tonë kërkonit në adresat:

- Ministria e Punës e Çështjeve Sociale :www.mpcs.gov.al
- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara:www.adrf.org.al

Përgatiti:

Jeta Lakrori

Departamenti i Promocinit